

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Reagimi - Dënohen 4 ish krerët e UÇK-së/ PDK: Në Hagë u godit rëndë e drejta e popullit që luftoi për lir i, vendimi i papranueshëm
ADRESA	https://www.syri.net/kosova/917047/denohen-4-ish-kreret-e-uck-se-pdk-ne-hage-u-godit-ren-de-e-drejta-e-popullit-qe-luftoi-per-liri-vendimi-i-papranueshem/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 10:55:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 10:43:11 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	12c02fbeb50e769188368d578e5dc45702c6433c5a4e8948793c4e9b9ad67641
TEKSTI	905cb893d3f574e1ef5832165111596a0d2c46e1433e81ea1c6f437c5e8e0d60
PAMJA	c311b59049ccec645ed5447758561fb0c74ebdd01e27cccf987e134beab1777b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e66fa9b851843caace4c883dd6f77bb3d97314ea229acf813417ae50dff7880a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	06975047e5a3601e37e96e97bfab995ceed02fbc2c1535a000f7cb9180af2b1a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.


Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e66fa9b851843caace4c883dd6f77bb3d97314ea229acf813417ae50dff7880a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**ILIR KALEMAJ**
Dokrra hini dhe bota në tranzicion**ENVER BYTYÇI**
Edi Rama edhe në varr nuk ndahet nga Aleksandër Vuçiq!

Dënohen 4 ish krerët e UÇK-së/ PDK: Në Hagë u godit rëndë e drejta e popullit që luftoi për liri, vendimi i papranueshëm

12:43, 16/09/2026

Partia Demokratike e Kosovës ka reaguar ndaj aktgjykimit të sotëm të Gjykatës Speciale në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit.

PDK shpreh indinjatën, zhgënjimin dhe kundërshtimin e saj për aktgjykimin, duke e cilësuar atë si një padrejtësi të madhe.

"Sot në Hagë u godit rëndë e drejta e popullit tonë që luftoi për liri, mbijetesë dhe çlirim nga regjimi shtetëror serb që vrau, dëboi dhe terrorizoi shqiptarët e Kosovës", thuhet në reagim.

Sipas PDK-së, aktgjykimi mbështetet në pretendime dhe materiale që partia i konsideron të fabrikuar dhe të ushqyera ndër vite nga aparati shtetëror dhe propaganda e Serbisë për ta kriminalizuar luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

"Ky aktgjykim mund të jetë shkruar në Hagë. Por, historia e Kosovës është shkruar këtu, me sakrificë, gjak dhe luftë për liri. Dhe ajo nuk rishkruhet sot", thuhet më tej.

PDK thekson se historia e Kosovës është shkruar nga populli që luftoi për mbijetesë, nga mijëra dëshmorë e martirë, nga qindra mijëra qytetarë të dëbuar prej shtëpive të tyre dhe nga aleanca me botën demokratike që, sipas saj, në vitin 1999 i dha fund represionit dhe spastrimit etnik të regjimit serb në Kosovë.

"Agresori ishte Serbia. Viktima ishte Kosova. Dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte përgjigjja e popullit tonë që kërkonte të jetonte i lirë. Këtë të vërtetë nuk mund ta ndryshojë asnjë aktgjykim", thuhet në reagim.

Partia Demokratike e Kosovës thotë se Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi nuk shkuan në Hagë duke ikur nga drejtësia, por iu përgjigjën asaj vullnetarisht, me besimin se e vërteta do të triumfojë.

"Prandaj, vendimi i sotëm është një goditje e rëndë për luftën e UÇK-së, lirinë, pavarësinë dhe shtetin e Kosovës", thuhet në reagim.

PDK thotë se qytetarët e Kosovës ndihen të lënduar dhe të zhgënjyer nga aktgjykimi, ndërsa paralajmëron se do ta kundërshtojë atë me argumente, me të gjitha mjetet demokratike dhe në çdo forum ku, siç shprehet, duhet mbrojtur e

më të lexuarat

Specialja: Të akuzuarit vepruan së bashku për një qëllim të përbashkët kriminal, Thaçi ishte anëtar kyç

'Thaçi kishte dijeni për krimet, Veseli mori pjesë dhe inkurajoi kryerjen e tyre'

'Selimi dha kontribut në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal, mori pjesë në kryerjen e krimeve'

PDK dërgon në Kushtetuese konstituimin e Kuvendit

Gjykata Speciale: Katër të akuzuarit janë penalisht përgjegjës për krime lufte!

Kurti thirrje liderëve politikë: Ta zgjidhim çështjen e presidentit

Ndërron jetë Flora Brovina, nesër do të dëshmonte për Masakrën e Dubravës

verjeta per luten e Kosoves.

"Për ne, lufta e UÇK-së ishte e drejtë, mbrojtëse dhe çlirimtare", thuhet në reagim.

Sipas PDK-së, njerëzit që udhëhoqën luftën dhe proceset politike që sollën lirinë dhe shtetin e Kosovës nuk mund të fshihen nga historia me një vendim gjyqësor.

"Sot është një ditë e rëndë për Kosovën. Por sot nuk përfundon as historia, as beteja për të vërtetën", thuhet në reagim.

PDK deklaron se do të qëndrojë në mbrojtje të së vërtetës historike, dinjitetit të luftës çlirimtare dhe atyre që, sipas saj, morën mbi vete barrën e lirisë së Kosovës.

"Ky aktgjykim nuk është fjala e fundit. Ne për drejtësinë do të luftojmë deri në fund dhe për të vërtetën nuk do të heshtim kurrë", përfundon reagimi.

"Heronjtë tanë të luftës dhe paqes nuk do t'i lëmë kurrë vetëm. Beteja vazhdon, me ta dhe për ta, deri në lirinë e tyre", thuhet në fund të reagimit të PDK-së.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Organizata e Veteranëve të Luftës: UÇK s'ka qenë kurrë ndërmarrje kriminale



Gucati: Nuk duhet t'i humbim shpresat, mbetet apeli



Albulena Haxhiu: Dënimet janë goditje e rëndë, fjala e fundit juridike nuk është thënë

Komentet

Shto koment

Emri

Shkruani komentin tuaj

Posto

TË NGJASHME



DOKUMENTI/ Publikohet vendimi i plotë i dënimit të Thaçit dhe të tjerëve



Dënohen ish krerët e UÇK-së/ Vajza e Jakup Krasniqit: Sot, në qytetin e drejtësisë, ndodhi padrejtësia më e madhe e këtij shekulli



Dënimi i ish krerëve të UÇK/ Komandanti Haradinaj: Shkelje e të drejtave të njeriut, mbrojtën lirinë e Kosovës



Gjini: Ky aktgjykim s'mund ta ndryshojë të vërtetën historike të Kosovës



Haradinaj bën thirrje për qetësi: Beteja për drejtësi të vazhdojë në shkallën e dytë



Reagon familja e Hashim Thaçit: Po presim Apelin, jemi të bindur në pafajësi





Informacioni në SYRI.net që të gjesh opinioniste në mënyrë të vendit tonë, mesazhinë dhe fjalë që nuk do të gjesh kurrë tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.